



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“BUJQËSI”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

H-IV-20

Tiranë, Maj 2020

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	BUJQËSI			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	IV KSHK, referuar nivelit IV të KEK	H-IV-20
Qëllimi:	<p>Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “BUJQËSI”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është të përgatisë specialistë të nivelit teknik/menaxher të mesëm në sektorin e bujqësisë dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin bujqësor/blegtoral apo për krijimin e menaxhimit të një ferme bujqësore/blegtorale private.</p>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “BUJQËSI” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kanë përfunduar një nga kualifikimet profesionale të nivelit III të KSHK, referuar nivelit III të KEK, drejtimin mësimor “BUJQËSI” • janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. • pranohen edhe individë që <u>kanë aftësi ndryshe</u>, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “BUJQËSI”, niveli i IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën e Profesionale dhe Supplementin përkatës të këtij niveli që përkon me nivelin profesional teknik/menaxher i mesëm në këtë fushë profesionale, të njohur në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në ferma bujqësore/blegtorale, si dhe institucione të ndryshme private/shtetërore që ushtrojnë aktivitetet në sektorin e bujqësisë si teknik, menaxher i mesëm.</p> <p>Gjithashtu, individit mund të vetëpunësohet në sektorin e bujqësisë në kuadrin e një biznesi individual të vogël apo të mesëm në fushën e bujqësisë.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individit ka mundësi për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, si dhe pajiset me Certifikatën e teknikut/menaxherit të ekonomive bujqësore. Me përfundimin e këtij niveli, individit ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin pas të mesëm ose në nivelin e studimeve universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	H-III-15			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

Në përfundim të kualifikimit profesional “BUJQËSI” niveli IV-të në KSHK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

NJOHURI PROFESIONALE

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e sipërmarrjes së biznesit (sociale dhe ekonomike) në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
- Të shpjegojnë kuptimin filozofik të kompanisë dhe misionin e saj në tregun e biznesit bujqësor;
- Të përshkruajë fazat e zhvillimit të biznesit bujqësor në kontekstin e globalizimit;
- Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të interpretojë rolin e etikës dhe sjelljes profesionale për një biznes bujqësor të suksesshëm;
- Të ilustrojë metoda të zgjidhjes së problemeve në kontekste të ndryshme;
- Të evidentojë mundësitë që ofron tregu i punës dhe kualifikimet e mëtejshme;
- Të përshkruajë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme);
- Të përshkruajë konceptin e ndërmarrjeve me përgjegjësi sociale në kontekste lokale dhe globale;
- Të përshkruajë metodat e vlerësimit dhe vetëvlerësimit të aftësive profesionale;
- Të shpjegojë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit dhe të menaxhimit të informacionit në një biznes bujqësor;
- Të listojë mjetet e nevojshme për sigurimin, ruajtjen, vlerësimin dhe shpërndarjen e informacionit, për të realizuar vendim-marrje në fermë;
- Të shpjegojë dobinë e marketingut në fermë;
- Të vlerësojë qëndrueshmërinë ekonomike për të ardhmen e fermës;
- Të listojë kuadrin ligjor dhe detyrimet administrative në fushën e biznesit përkatës, si pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes së tij.

Menaxhimi financiar i fermës

- Të shpjegojë konceptet bazë financiare (dokumente financiare, institucione financiare);
- Të përshkruajë procedurën e kryerjes së preventivit të një produkti bujqësor;
- Të përshkruajë elementët e përcaktimit të kostos së prodhimit të një produkti bujqësor;
- Të argumentojë lidhjet e madhësisë së fermës me kostot;
- Të shpjegojë llogaritjen e kostos dhe rrugët për uljen e saj;
- Të dallojë ndryshimin ndërmjet shpenzimeve direkte dhe indirekte në prodhimet

bujqësore;

- Të përshkruajë elementët e përcaktimit të çmimit të produkteve bujqësore dhe rëndësinë e tyre;
- Të përshkruajë përlogaritjen e kohës kryesore dhe ndihmëse për prodhimet bujqësore;
- Të përshkruajë domosdoshmërinë dhe strukturën e buxhetit të një ferme;
- Të rendisë burimet e sigurimit të kapitalit në fermë dhe faktorët që ndikojnë në marrjen dhe dhënien e kredisë në bujqësi;
- Të rendisë burimet e sigurimit të makinerive bujqësore: blerja ose marrja me qira e tyre;
- Të përshkruajë buxhetin e lëvizjes së parave në fermë;
- Të përshkruajë llojet e riskut dhe qëndrimet e fermerit ndaj tyre;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e rritjes së fermës në varësi të burimeve financiare;
- Të përshkruajë procedurën e administrimit të vlerave monetare, dokumentacionin përkatës për administrimin e tyre, veprimet me arkën, veprimet me bankën, regjistrat e magazinimit, fletë hyrjet dhe fletë daljet, blerjet dhe shitjet e ndryshme që realizon ferma;

Menaxhimi i burimeve njerëzore në fermë

- Të shpjegojë kuptimin dhe nevojën për menaxhimin e burimeve njerëzore (personelit);
- Të përshkruajë rolin e burimeve njerëzore në suksesin e një ferme;
- Të përshkruajë rëndësinë e procesit të planifikimit të burimeve njerëzore të fermës;
- Të argumentojë domosdoshmërinë e planifikimit të burimeve njerëzore;
- Të shpjegojë rëndësinë e procesit të rekrutimit të burimeve njerëzore;
- Të analizojë rëndësinë e motivimit të burimeve njerëzore;
- Të argumentojë domosdoshmërinë e ngritjes profesionale të punonjësve si faktor në suksesin e një ferme;
- Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të performancës së punonjësve të një ferme;
- Të shpjegojë përdorimin me efektivitet të burimeve njerëzore në fermë.

Organizimi dhe drejtimi në fermë

- Të përshkruajë rëndësinë e organizimit të punës në fermë, si një element mjaft i rëndësishëm i menaxhimit të fermës;
- Të shpjegojë format e ndryshme të organizimit të fermës;
- Të shpjegojë mënyrën e organizimit të punës për drejtimin/menaxhimin e njësive të prodhimeve në fermë;
- Të përshkruajë rolin dhe rëndësinë e strukturës organizative si një nga elementët më i rëndësishëm i organizimit të punës në fermë;
- Të listojë faktorët që ndikojnë në organizimin e punës dhe ndikimin e tyre në suksesin e fermës;
- Të shpjegojë nevojën e planifikimit të veprimtarive në fermë;
- Të argumentojë rolin dhe rëndësinë e faktorit teknik në cilësinë e organizimit të punës të një ferme;
- Të përshkruajë domosdoshmërinë e drejtimit të fermave bujqësore;
- Të shpjegojë funksionet bazë të menaxhimit të fermave;
- Të shpjegojë mënyrën e planifikimit të procesit të prodhimit, në vartësi të llojit të tij;

- Të shpjegojë veçoritë e tregut bujqësor dhe liberalizimin e tij;
- Të shpjegojë si funksionojnë kërkesat dhe ofertat në sektorin bujqësor;
- Të argumentojë rolin e fermave të vogla dhe të mesme në ekonominë e vendit;
- Të shpjegojë veçoritë specifike të vendit tonë për zhvillimin bujqësor dhe potencialet prodhuese për të ardhmen;
- Të analizojë rubrikat e një plani prodhimi bujqësor;
- Të listojë indikatorët e kushteve të punës, si një element shumë i rëndësishëm i organizimit të punës, rëndësinë e tyre në rritjen e rendimentit dhe suksesin e fermës;
- Të listojë llojet e dokumentacionit përkatës në funksion të organizimit të punës (urdhër pune, proces verbale të fillimit dhe mbarimit të punës etj).

Kontabilitet bujqësor

- Të shpjegojë qëllimet, rolin dhe rëndësinë e kontabilitetit të fermave bujqësore;
- Të shpjegojë nocionin e inventarizimit, përmbajtjen dhe formën e inventarëve;
- Të shpjegojë procedurat në kontrollin dhe dokumentimin e inventarit bujqësor;
- Të shpjegojë nocionet e pasurisë, kapitalit, aktiveve, pasiveve dhe të bëjë dallimet përkatëse;
- Të shpjegojë kuptimin, përmbajtjen, llojet dhe qëllimin e mbajtjes së llogarive bujqësore;
- Të argumentojë regjistrimin e veprimeve të thjeshta ekonomike me metodën e regjistrimit të dyfishtë;
- Të shpjegojë konceptet e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndikimin e tyre në kapitalin e fermës;
- Të argumentojë funksionimin e llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve në fermë;
- Të analizojë rezultatin e fermës bujqësore;
- Të argumentojë shlyerjen e detyrimit ndaj shtetit për TVSH-në;
- Të shpjegojë regjistrimet kontabël në fushën e personelit dhe qarkullimin e pagesave;
- Të shpjegojë nocionet bazë të aktiveve të qëndrueshme dhe atyre qarkulluese;
- Të përshkruajë procedurën e plotë që çon në hartimin e bilancit përfundimtar;
- Të argumentojë domosdoshmërinë e analizës dhe vlerësimit të mbylljes vjetore.

Përmirësimi ujqor

- Të analizojë faktorët që përcaktojnë nevojën për ujë;
- Të diferencojë format e ujit në tokë dhe marrëdhëniet tokë – ujë – bimë;
- Të interpretojë elementet bazë të përcaktimit të nevojave të bimës për ujë;
- Të shpjegojë dukurinë e infiltrimit, si dhe marrëdhëniet midis ritmit të infiltrimit dhe furnizimit të tokës me ujë;
- Të shpjegojë evapotranspirimin dhe faktorët që ndikojnë në të;
- Të interpretojë normën agronomike të ujitjes;
- Të interpretojë treguesit më të rëndësishëm, të cilat përcaktojnë cilësinë e ujit;
- Të argumentojë domosdoshmërinë e monitorimit dhe të mbikëqyrjes së cilësisë së ujit;
- Të përshkruajë procedurat e monitorimit të formave të ujitjes së bimëve.

Sistemimi i tokave

- Të interpretojë legjislacionin kombëtar për rregullimin e territorit në përgjithësi dhe atij për mbrojtjen e tokës në veçanti;

- Të përshkruajë faktorët që ndikojnë në gërryerjen e tokës;
- Të argumentojë rëndësinë e sistemimit të tokës si dhe llojet e sistemimit sipërfaqësor (rrafsh dhe kurriz);
- Të argumentojë domosdoshmërinë e monitorimit dhe mbikëqyrjes së sistemimit të tokës;
- Të argumentojë rolin e sistemimit ekstensiv të tokave të pjerrëta si dhe mënyrat e sistemimit të tyre sipas llojit të pjerrësisë;
- Të shpjegojë rolin e ndërtimit të brezareve në tokat e pjerrëta dhe elementët përbërës të brezareve;
- Të përshkruajë mënyrat e ndërtimit të brezareve në tokat e pjerrëta;
- Të përshkruajë procedurat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së ndërtimit të brezareve në tokat e pjerrëta.

Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm

- Të shpjegojë kuptimin për “mjedisin” dhe “mbrojtjen e mjedisit”;
- Të shpjegojë kuptimin për “zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor”;
- Të përshkruajë ndikimin e faktorëve klimatik në zhvillimin mjedisor;
- Të shpjegojë veprimtarinë e njeriut në mjedisin rrethues;
- Të përshkruajë burimet kryesore të mjedisit jetësor;
- Të shpjegojë marrëdhëniet midis zhvillimeve demografike dhe mjedisit jetësor;
- Të analizojë ndikimin e mbetjeve urbane në mjedisin jetësor;
- Të shpjegojë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore si dhe sistemet e manaxhimit të mjedisit;
- Të hulumtojë dhe identifikojë problemet mjedisore në njësitë vendore;
- Të analizojë problematikat dhe të planifikojë nisma mjedisore në nivel lokalë për mbrojtjen e mjedisit;
- Të shpjegojë rolin e lanfilleve në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Të argumentojë domosdoshmërinë e monitorimit, menaxhimit dhe përpunimit të mbetjeve urbane;
- Të përshkruajë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Bujqësia organike

- Të shpjegojë rëndësinë e bujqësisë organike, përfitimet ekonomike, shëndetësore dhe ekologjike të saj;
- Të përshkruajë epërsitë e bujqësisë organike ndaj bujqësisë së zakonshme;
- Të shpjegojë burimet natyrore të bujqësisë organike (tokë, ujë, ajër, etj.);
- Të shpjegojë ndikimin e ndotësve të tokës në bujqësinë organike dhe masat për zvoglimin e ndotjes;
- Të shpjegojë arsyet e ngrohjes globale dhe ndikimi në prodhimin organik;
- Të shpjegojë masat biologjike për ruajtjen e pjellorisë së tokës, pastërtisë së ujit dhe ndikimi i mbeturinave të tij në bujqësinë organike;
- Të përshkruajë mundësitë potenciale të zhvillimit të bujqësisë organike në Shqipëri.

Agroteknologjia e prodhimit organik

- Të analizojë materialin fillestar (farë, fidanë, bulba etj.) si garanci për kultivimin e bimëve organike;
- Të krahasojë veçoritë e prodhimeve *BIO* nga *OMGJ*;
- Të shpjegojë mënyrat e përfimit të *OMGJ* nëpërmjet mutacioneve natyrore dhe atyre artificiale (kimike, fizike etj.);
- Të interpretojë hallkat agroteknologjike të prodhimit organik nga fara deri tek produkti, duke theksuar mbrojtjen biologjike, agroteknike dhe të integruar nga barërat e këqija, sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Të përshkruajë metodat kryesore të mbrojtjes së kulturave në bujqësinë organike;
- Të përshkruajë procedurat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së mbrojtjes së intergruar në bujqësinë organike.

Mbarështimi organik i kafshëve dhe akuakultura organike

- Të shpjegojë rregullat që aplikohen në lidhje me origjinën e kafshëve të një ferme organike si dhe prodhimet blegtorale të tyre;
- Të shpjegojë praktikatat e mbarështimit të kafshëve në fermën organike;
- Të shpjegojë rregullat e të ushqyerit organik dhe ndikimet e tij në produktet blegtorale;
- Të shpjegojë metodat e riprodhimit të kafshëve në kushtet e një prodhimi biologjik;
- Të shpjegojë metodat e parandalimit të sëmundjeve të kafshëve dhe trajtimin veterinar në kushtet e një ferme biologjike;
- Të shpjegojë mënyrat e rritjes së gjallesave ujore;
- Të përshkruajë procedurat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së mbarështimit organik të kafshëve dhe akuakulturave organike;
- Të argumentojë mundësinë e zhvillimit të akuakulturës si degë e ekonomisë në Shqipëri.

Kalimi në bujqësi organike

- Të analizojë tiparet e bujqësisë tradicionale në vendin tonë;
- Të përshkruajë treguesit dhe kriteret për hartimin dhe modelimin e një ferme organike;
- Të përshkruajë rrugët dhe hapat për kalimit nga bujqësia tradicionale në atë organike;
- Të shpjegojë procesin e projektimit të një ferme organike sipas zonave klimatike;
- Të përshkruajë procedurat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së kalimit në ferma organike.

Kultivimi i bimëve pa tokë

- Të përshkruajë rolin ekonomik dhe mjedisor të kultivimit të bimëve pa tokë;
- Të evidentojë rëndësinë ekonomike dhe mjekësore të kultivimit të kërpudhave;
- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të kërpudhave;
- Të shpjegojë mundësitë reale të kultivimit të bimëve pa tokë si një risi në bujqësi;
- Të përshkruajë mënyrën e kultivimit të bimëve në mjedise ujor pa tokë – hidroponia;
- Të përshkruajë mënyrën e kultivimit të bimëve në ajër me mjegullim ushqyes;

- Të përshkruajë procedurat e monitorimit dhe mbikëqyrjes së kultivimit të bimëve pa tokë.

Shitja e produkteve bujqësore e blegtorale

- Të klasifikojë produktet bujqësore e blegtorale në pikën e shitjes;
- Të përshkruajë mënyrën e tregtimit të produkteve *BIO*;
- Të shpjegojë rregullat dhe parimet në organizimin e pikës së shitjes së produkteve bujqësore e blegtorale;
- Të argumentojë domosdoshmërinë e marketingut për prodhimet bujqësore vendase;
- Të argumentojë nevojën dhe rolin e kontrollit të cilësisë për produktet bujqësore e blegtorale.

Legjislacioni

- Të shpjegojë parimet, burimet, sistemet dhe subjektet e së drejtës;
- Të shpjegojë kuptimin e së drejtës agrare, raportin e saj me degët e tjera të së drejtës;
- Të shpjegojë ç’ është prona dhe elementët e së drejtës së pronësisë;
- Të argumentojë bashkëpronësinë dhe shpronësimin;
- Të shpjegojë kontratat, llojet e kontratave;
- Të analizojë qiranë e tokës, livadheve dhe kullotave;
- Të analizojë aspektet ligjore të sipërmarrjeve bujqësore;
- Të përshkruajë dispozitat ligjore në fushën e shpërblimeve, tatimeve mbi të ardhurat dhe detyrimeve të punëdhënësit e të punëmarrësit ndaj sigurimeve shoqërore;
- Të listojë disa standarde që veprojnë në fushën e legjislacionit të punës në sektorin bujqësor;
- Të argumentojë domosdoshmërinë e respektimit të normativave ligjore përkatëse në pikën e shitjes së prodhimeve organike;
- Të përshkruajë rëndësinë e njohjes së legjislacionit për prodhimin organik;
- Të përshkruajë legjislacionin Evropian dhe atë Shqiptar për prodhimin organik;
- Të përshkruajë legjislacionin e Certifikimit, etiketimit dhe tregtimit të produkteve organike.

Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të shpjegojë legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë të punonjësve;
- Të përshkruajë faktorët që ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve dhe masat që merren për evitimin e tyre;
- Të listojë mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes individuale dhe kolektive duke shpjeguar dhe përdorimet e tyre;
- Të listojë llojet e mundshme të aksidenteve gjatë kryerjes së punimeve dhe shërbimeve në bujqësi si dhe mënyrën e shmangies së tyre;
- Të shpjegojë, për çdo post pune, rregullat e sigurimit teknik në punë;
- Të përshkruajë rëndësinë e afishimit të rregullave të sigurimit teknik në çdo post pune;
- Të shpjegojë legjislacionin shqiptar të parandalimit, mbrojtjes, neutralizimit dhe shpëtimit ndaj fatkeqësive natyrore, zjarri etj., si dhe evakuimin e punonjësve;
- Të përshkruajë shkaqet e aksidenteve në punë dhe masat që duhet të merren për evitimin

- e tyre;
- Të përshkruajë raste të aksidenteve që mund të ndodhin në fermat bujqësore e blegtorale dhe masat që merren për parandalimin e tyre;
- Të përshkruajë veprimet e nevojshme që duhen kryer për të dhënë ndihmën e parë për të dëmtuarin në punë;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar, që përfshinë aspektet teknike, lejet, shkallët e përgjegjësisë, dokumentacionin e detyrueshëm, raportimet periodike, etj. të mbrojtjes së mjedisit në punë;
- Të përshkruajnë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- Të përshkruajë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit nga mbetjet bujqësore e blegtorale;
- Të përshkruajë masat që duhen marrë dhe pajisjet e nevojshme për të bërë neutralizimin e efekteve të dëmshme të mbetjeve bujqësore e blegtorale.

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar një projekt ide sipërmarrëse (për të zhvilluar dhe zbatuar një buxhet të caktuar);
- Të përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të zbatimit të një projekti;
- Të marrë vendimet e duhura në kontekste të ndryshme;
- Të identifikojë dhe të zgjidhë problem në mënyrë krijuese;
- Të negociojë ide me të tjerët në mënyrë efektive;
- Të demonstrojë aftësi për të njohur dhe vlerësuar risqet;
- Të demonstrojë aftësi për të planifikuar, bërë, kontrolluar dhe vepruar me qëllim për t'u vetë-përmirësuar;
- Të vlerësojë potencialin personal (aftësitë personale, sociale dhe për biznes, njohuritë e mëparshme..) për të shfrytëzuar avantazhin konkurrues;
- Të demonstrojë aftësi udhëheqëse në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të aplikuar parimet e ekonomisë së lirë të tregut në situata të ndryshme;
- Të demonstrojë aftësi për të motivuar dhe inkurajuar të tjerët në arritjen e synimeve të tyre;
- Të aplikojë aftësitë për planifikim dhe menaxhim projekti në situata të ndryshme;
- Të sigurojë burimet e duhura dhe të marrë përgjegjësinë për t'u kujdesuar për to;
- Të menaxhojë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës;
- Të hartojë një plan efektiv biznesi në bujqësi për krijimin e e një ferme të vogël duke u bazuar në procedura standarde;
- Të kryejë detyra tekniko-menaxheriale, nën mbikëqyrjen e drejtuesve, për realizimin e një plan biznesi, sipas planeve e programeve të hartuara nga menaxherët e nivelit më të

lartë ose të një stafi menaxherial.

Menaxhimi financiar i fermës

- Të hartojë preventivin për prodhimin e një produkti bujqësor;
- Të kryejë llogaritjen e kostos së një produkti të caktuar bujqësor;
- Të kryejë llogaritjen e shpenzimeve direkte dhe indirekte në prodhimet bujqësore;
- Të kryejë llogaritjen e çmimit të produkteve bujqësore;
- Të kryejë llogaritjen e kohës kryesore dhe ndihmëse për prodhimet bujqësore;
- Të hartojë strukturën e buxhetit të një ferme të vogël;
- Të llogarisë totalin e nevojshëm të investimeve për të filluar veprimtarinë në fermë;
- Të llogarisë nevojën e financimit me kapital të vet dhe financimin me kapital hua;
- Të kryejë procedurën për marrjen e një kredie në bankë;
- Të hartojë buxhetin e lëvizjes së parave në fermë;
- Të hartojë një plan masash për fermën në raste të fatkeqësive natyrore (përmbytje, tërmete, rrëshqitje dheu, zjarri etj.);
- Të zbatojë me rigorozitet procedurën e administrimit të vlerave monetare, dokumentacionin përkatës për administrimin e tyre, veprimet me arkën, veprimet me bankën, regjistrat e magazinimit, fletë hyrjet dhe fletë daljet, blerjet dhe shitjet e ndryshme që realizon ferma.

Menaxhimi i burimeve njerëzore në fermë

- Të përcaktojë nevojat e fermës për burime njerëzore (personel);
- Të përcaktojë kriteret për planifikimin e burimeve njerëzore të fermës;
- Të përcaktojë kriteret për rekrutimin e burimeve njerëzore në fermë;
- Të përcaktojë kriteret për motivimin e burimeve njerëzore në fermë;
- Të hartojë planin e zhvillimit të ngritjes profesionale të punonjësve të fermës;
- Të përcaktojë kriteret e vlerësimit të performancës së punonjësve të fermës;
- Të vlerësojë performancën e punonjësve.

Organizimi dhe drejtimi në fermë

- Të përcaktojë objektivat e organizimit të punës në fermë;
- Të përcaktojë faktorët që ndikojnë në organizimin e punës dhe ndikimin në suksesin e fermës;
- Të përcaktojë kriteret dhe rregullat e organizimit të vogël të punës (ne një post pune);
- Të organizojë një fermë të vogël bujqësore me veprimtari mikse ose të profilizuar;
- Të zbatojë procedurën e hapjes së një biznesi bujqësor;
- Të hartojë një plan-biznesi për një aktivitet të caktuar bujqësor;
- Të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Të përcaktojë strukturën organizative të fermës;
- Të përcaktojë funksionet bazë të menaxhimit të fermave;
- Të kryejë procesin e planifikimit të procesit të prodhimit, në vartësi të llojit të tij;
- Të zbatojë rubrikat e një plani prodhimi bujqësor;
- Të përcaktojë indikatorët e kushteve të punës, si një element shumë i rëndësishëm i organizimit të punës, rëndësinë e tyre në rritjen e rendimentit dhe suksesin e fermës;

- Të përcaktojë llojet e dokumentacionit përkatës në funksion të organizimit të punës (urdhër pune, proces verbale të fillimit dhe mbarimit të punës etj.);
- Të zhvillojë marketingun e produkteve bujqësore e blegtorale dhe nënprodukteve të tyre;
- Të përdorë teknologjinë e informimit dhe komunikimit, për të bërë të mundur bashkëpunimin dhe mbajtjen e korrespondencave me ferma të tjera si ato vendase dhe të huaja;
- Të krijojë raporte njerëzore dhe profesionale të domosdoshme për sukses në vendin e punës dhe jashtë saj.

Kontabilitet bujqësor

- Të hartojë listën e elementëve pasurore të nevojshëm për funksionimin e fermës;
- Të vlerësojë pasurinë fillestare të nevojshme të fermës, në lloje dhe sasi;
- Të grupojë elementët pasurore sipas afateve të përdorimit të tyre në fermë;
- Të hartojë një inventar të thjeshtë dhe bilancin fillestar të fermës;
- Të çelë regjistrat e kontabilitetit të fermës bujqësore dhe të hartojë dokumente pune si dhe formularë biznesi;
- Të hartojë regjistrat e magazinës dhe të regjistrojë hyrjet dhe daljet nga magazina;
- Të kontrollojë gjendjet e mallrave dhe hartojë kërkesat për furnizimet e reja;
- Të kryejë blerjet në fermën bujqësore si dhe regjistrimet përkatëse;
- Të hartojë faturat e shitjes dhe të kryejë regjistrimet përkatëse;
- Të kontabilizojë daljen e mallrave nga magazina dhe të hartojë dokumentet shoqërues të mallrave gjatë transportit;
- Të mbajë arkën dhe të kryejë veprime pagesash;
- Të kryejë regjistrimet kontabël të arkëtive dhe pagesave dhe ti dokumentojë ato;
- Të zbatojë metodën e regjistrimit të dyfishtë në regjistrimin e veprimeve të thjeshta ekonomike;
- Të plotësojë dokumentacionin përkatës për të ardhurat dhe shpenzimet e fermës;
- Të kryejë regjistrimet përkatëse të llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve në fermë;
- Të llogarisë rezultatin e fermës, ndikimin e tyre në kapitalin e fermës;
- Të hartojë dokumentacionin dhe shlyerjen e detyrimit ndaj shtetit për TVSH-në;
- Të kryejë regjistrimet kontabël në fushën e personelit dhe qarkullimin e pagesave;
- Të zbatojë procedurën e plotë që çon në hartimin e bilancit përfundimtar;
- Të kryejë analizën dhe vlerësimin e mbylljes vjetore.

Ujitja e tokave

- Të përcaktojë nevojat, kohën, sasinë dhe mënyrën e ujitjes së tokës;
- Të përcaktojë elementet bazë të nevojave të bimëve për ujë;
- Të përcaktojë treguesit më të rëndësishëm të cilësisë së ujit;
- Të kryejë ujitjen me përmbytje të tokës;
- Të zbatojë ujitjen me pika të bimës;
- Të kryejë ujitje me shihedhje të bimëve;
- Të kryejë monitorimin dhe mbikëqyrjen e formave të ndryshme të ujitjes së bimëve;
- Të llogarisë normën agronomike të ujitjes së bimëve.

Sistemimi i tokave

- Të përcaktojë faktorët që ndikojnë në gërryerjen e tokës;
- Të përcaktojë masat për mbrojtjen e tokës nga gërryerjet;
- Të organizojë nisma për ndërgjegjësimin e njerëzve për shfrytëzimin e tokës me kriter;
- Të ndërtojë breza pyjorë për mbrojtjen e tokës nga gërryerja;
- Të kryejë sistemimin e tokës me një nga llojet e sistemimit sipërfaqësor (rrafsh dhe kurriz);
- Të kryejë ndërtimin dhe sistemimin e brezareve në tokat e pjerrët;
- Të kryejë monitorimin dhe mbikëqyrjen e sistemimit të tokave të pjerrëta.

Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm

- Të vlerësojë rolin e mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të mjedisit rrethues;
- Të organizojë nisma dhe veprimtari të ndryshme mjedisore;
- Të kryejë mbjelljen e pemëve dhe gjelbërimin e mjedisit rrethues;
- Të përcaktojë ndikimin e mbetjeve urbane në mjedisin jetësor si dhe në jetën tonë;
- Të kryejë monitorimin, sistemin dhe menaxhimin e mbetjeve mjedisore në njësitë vendore.

Prodhimi organik bujqësor

- Të zbatojë agroteknologjinë e prodhimit organik për kulturat e arave dhe perimeve;
- Të zbatojë masat biologjike për ruajtjen e pjellorisë së tokës në prodhimin bujqësor;
- Të përcaktojë me metoda të thjeshta aftësinë e tokës për të prodhuar produkte organike;
- Të zbatojë mbrojtjen e kulturave bujqësore organike ndaj sëmundjeve, dëmtuesve dhe barishteve të këqija;
- Të kryejë monitorimin dhe mbikëqyrjen e procedurave të mbrojtjes organike të bimëve.

Prodhimi organik blegtoral dhe akuakultura

- Të zbatojë mbarështimin organik në mjedise të caktuara sipas kategorive të kafshëve;
- Të hartojë racionet ushqimore të kafshëve me mbarështim organik;
- Të monitorojë zbatimin e racioneve ushqimore të kafshëve me mbarështim organik;
- Të zbatojë riprodhimin natyror të kafshëve në fermën organike;
- Të monitorojë procedurat e riprodhimit natyror dhe artificial të kafshëve në fermën organike
- Të kryejë monitorimin dhe mbikëqyrjen e mbarështimit organik të kafshëve;
- Të zbatojë kujdesin zooteknik dhe veterinarë të kafshëve të fermës organike;
- Të aplikojë mënyrat e rritjes së gjallesave ujore sipas orientimeve bashkëkohore
- Të monitorojë mënyrat e rritjes së gjallesave ujore sipas orientimeve bashkëkohore.

Kalimi në bujqësi organike

- Të krahasojë tiparet e bujqësisë tradicionale me bujqësinë organike;
- Të përcaktojë kriteret për hartimin dhe modelimin e një ferme organike;
- Të kryejë procedurat për kalimin nga bujqësia tradicionale në atë organike;
- Të hartojë një projekt të një ferme organike sipas zonave klimatike;
- Të kryejë monitorimin dhe mbikëqyrjen e procedurave të kalimit në ferma organike.

Kultivimi i bimëve pa tokë

- Të përcaktojë rëndësinë ekonomike dhe mjekësore të kultivimit të kërpudhave;
- Të kryejë kultivimin e kërpudhave sipas teknologjisë bashkëkohore;
- Të përcaktojë mundësitë reale të kultivimit të bimëve pa tokë;
- Të kryejë kultivimin e bimëve në mjedise ujor pa tokë;
- Të zbatojë kultivimin e bimëve me mjegullim ushqyes;
- Të kryejë monitorimin dhe mbikëqyrje e kultivimit të bimëve pa tokë.

Shitja e produkteve bujqësore e blegtorale

- Të kryejë shitjen e produkteve bujqësore e blegtorale në pikën e shitjes;
- Të zbatojë mënyrën e tregtimit të produkteve *BIO*;
- Të zbatojë rregullat dhe parimet e organizimit të pikës së shitjes së produkteve bujqësore e blegtorale;
- Të zbatojë teknikat e marketingut për prodhimet organike bujqësore dhe blegtorale vendase;
- Të monitorojë zbatimin e rregullave të sigurimit të cilësisë për prodhimet organike bujqësore e blegtorale.

Legjislacioni

- Të zbatojë standardet teknike në fushën e prodhimit bujqësor dhe blegtoral;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar për aspekte të ndryshme të fermave bujqësore;
- Të zbatojë dispozitat ligjore në fushën e shpërblimeve, tatimeve mbi të ardhurat dhe detyrimeve të punëdhënësit e të punëmarrësit ndaj sigurimeve shoqërore;
- Të zbatojë normativat ligjore përkatëse në pikën e shitjes së prodhimeve organike;
- Të zbatojë legjislacionin për prodhimet organike;
- Të zbatojë legjislacionin Evropian dhe atë Shqiptar për prodhimin organik;
- Të zbatojë legjislacionin e Certifikimit, etiketimit dhe tregtimit të produkteve organike.

Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë të punonjësve;
- Të evidentojë faktorët që ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve dhe masat që merren për evitimin e tyre;
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes në punë gjatë kryerjes së punimeve dhe shërbimeve në bujqësi;
- Të evidentojë shkaqet e aksidenteve gjatë kryerjes së punimeve dhe shërbimeve në fermë si dhe mënyrën e shmangies së tyre;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve dhe shërbimeve në fermë;
- Të krijojë këndin e afishimit të rregullave të sigurimit teknik në çdo post pune në ferme;
- Të zbatojë legjislacionin shqiptar të parandalimit, mbrojtjes, neutralizimit dhe shpëtimit ndaj fatkeqësive natyrore, zjarri etj., si dhe evakuimin e punonjësve;
- Të përcaktojë veprimet e nevojshme që duhen kryer për të dhënë ndihmën e parë për të dëmtuarin në punë;

- Të zbatojë legjislacionin shqiptar, që përfshijnë aspektet teknike, lejet, shkallët e përgjegjësisë, dokumentacionin e detyrueshëm, raportimet periodike, etj. të mbrojtjes së mjedisit në punë;
- Të zbatojë kuadrin ligjor dhe institucional ndërkombëtar në lidhje me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- Të zbatojë mekanizmat e monitorimit të burimeve mjedisore;
- Të evidentojë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit nga mbetjet bujqësore e blegtorale;
- Të përgatisë rregullore dhe dokumentacionin përkatës për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Të përshkruajë masat që duhen marrë dhe pajisjet e nevojshme për të bërë neutralizimin e efekteve të dëmshme të mbetjeve bujqësore e blegtorale.

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Individi duhet të dijë të:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetë vlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
- Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
- Të marrë nisma për të bashkëpunuar më individë apo grupe;
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
- Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
- Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike;
- Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
- Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide;
- Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj;
- Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.